



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

---

Numri i lëndës: 2020:152728

Datë: 02.09.2022

Numri i dokumentit: 03390811

**P.nr.1023/20**

### **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal**, si gjykatë e shkallës së parë penale me gjyqtaren e vetme gjykuese Mimoza Shabani, procesmbajtëse Arta Podvorica – zyrtare ligjore, në çështjen penale kundër të akuzuarit D.S. me vendbanim në Ferizaj rruga “.....” nr....., për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par. 1 nënpar. 1.4 të KPRK-ës, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm e evidentuar me numër: PP/II.nr.1433/20 e datës 01 Dhjetor 2020, pas shqyrtimit fillestar dhe publik të mbajtur me datë 13 Maj 2022 në praninë e Prokurorit të shtetit L. B. si dhe të akuzuarit, me datë 16 Maj 2022 mori dhe publikisht komunikoi, ndërsa me datë 13 Qershor 2022, përpiloi me shkrim këtë:

### **A K T G J Y K I M**

**I akuzuari: D.S.** i lindur më ..... në Prishtinë, nga i ati A. dhe e ëma H. e gjinisë M., me vendbanim rrugën “.....” nr..... në Ferizaj, i gjendjes së mesme ekonomike, ka të kryer shkollën fillore, me profesion ..., i martuar, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal .....

## ËSHTË FAJTOR

### Sepse:

Me datën 25.09.2020, rreth orës 01:00h pas mesnate, në rrugën “Fan Noli”, Ferizaj i pandehuri pas një mosmarrëveshje – fjalosje me të dëmtuarën-viktimën Xh.D. duke vepruar me dashje e sulmon fizikisht duke e goditur disa here me grushta duarthatë në fytyrë ku nga goditjet e dëmtuara ka pësuar lëndime të lehta trupore të përshkruara si në ekspertizën e ekspertit mjekoligjorë të datës 18.11.2020 të cilat lëndime rezultojnë me pasoja – dëmtim të përkohshëm të shëndetit.

- **me të cilin veprim ka kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 1 nënpar.1.4 të KPRK-ës.**

Andaj, Gjykata në bazë dispozitës së lartë shënuar si dhe neneve 2, 4, 7, 8, 17, 38, 39, 46, 47, 48, 49, 69 dhe 70 të KPRK-së, si dhe në bazë të neneve 365, 370, 453,463, të KPP-së, të akuzuarin e,

## G J Y K O N

Dënim me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda periudhës verifikuese prej një (1) viti, pasi aktgjykimi të merr formën e prerë nuk kryen veprë tjetër penale, në të kundërtën gjykata do të revokoj dënimin me kusht.

E dëmtuara Xh.D. me vendbanim në rrugën “.....” nr. ... në Ferizaj, ka hequr dorë nga kërkesa pasurore-juridike.

Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 Euro /njëzetë euro/ dhe shumën prej 20 Euro /njëzetë euro/, në emër të shpenzimeve të procedurës penale (ekspertizës mjekoligjore) si dhe shumën prej 30 Euro /tridhjetë euro/ në emër të kompensimit të viktimave të krimit brenda afatit prej tridhjetë (30) ditë, pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë, ose do të bëhet përmbarimi i detyruar sipas detyrës zyrtare.

## **A r s y e t i m**

### **Historiku procedurës dhe aktakuza**

Gjykata Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm Penal, me gjyqtaren e vetme gjykuese në çështjen penale kundër të akuzuarit D.S me vendbanim në Ferizaj rruga “.....”, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 1 nënpar.1.4 të KPRK-ës, sipas aktakuzës së Prokuroria Themelore në Ferizaj - Departamenti i Përgjithshëm me numër: PP/II.nr.1433/20 e datës 01 Dhjetor 2020, duke vepruar në këtë çështje penale në bazë të nenit 242 par.5 të KPP-ës, ka mbajtur shqyrtimin fillestar me datë 13 Maj 2022, në prezencën e prokurorit të shtetit si dhe të akuzuarit.

Gjyqtarja e vetme gjykuese pasi ka udhëzuar të akuzuarin në bazë të nenit 246 par.1 të KPP-ës dhe pasi prokurori i shtetit ka lexuar aktin akuzues dhe pasi gjyqtarja u bind se i njëjti e ka kuptuar aktakuzës, në bazë të nenit 246 par. 4 si dhe pas njoftimit sipas dispozitave të neneve 325 dhe 323 të KPPK-ës, të njëjtit i ofroj mundësinë të pranojë fajësinë ose të deklarohet i pafajshëm.

### **Pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit**

I akuzuari me rastin e deklarimit lidhur me fajësinë apo pafajësinë për veprën penale për të cilat është akuzuar, në shqyrtimin fillestar ka theksuar se e ndien veten fajtor dhe e pranon fajësinë sipas të gjitha pikave të aktakuzës, pranimin e ka bërë në mënyrë vullnetare duke qenë i vetëdijshëm për pasojat që mund të vijnë si rezultat i pranimit të fajësisë, duke shtuar se kërkon falje për këtë çka ka ndodhur, kjo ka ndodhur si rezultat i një mosmarrëveshje të çastit por nuk ka pasur për qëllim që ti shkaktoj lëndime të dëmtuarës.

Pasi që i akuzuari e ka pranuar fajësinë në shqyrtimin fillestar, gjyqtarja e vetme gjykuese duke vepruar në pajtim me nenin 248 par.2 të KPPK-së, ka kërkuar edhe mendimin e prokurorit të shtetit.

Prokurori i Shtetit, me rastin e paraqitjes së mendimit lidhur me pranimin e fajësisë nga akuzuari ka deklaruar se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga ana e akuzuarit, pasi pranimi fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare dhe në përputhje me dispozitat ligjore të nenit 248 të KPRK-së si dhe provat materiale dhe faktet e çështjes, prandaj i propozoi gjykatës që të njëjtën ta shpallë fajtor, po ashtu i propozoj gjykatës që të ketë parasysh si rrethan rënduese faktin se i njëjti është dhe recidivist i shumë veprave penale sidomos rasteve të ndodhura **dhunë në familje** andaj gjykata të ketë parasysh këtë dhe ti shqiptojë një dënim meritor me anë të cilit do të arrihet qëllimi i dënimit dhe të jetë një preventiv për parandalimin e përsëritjes së veprave të tilla penale.

E dëmtuara Xh.D. lidhur me pranimin e fajësisë ka deklaruar se nuk i bashkangjitet ndjekjes penale dhe se e ka falur të njëjtin pasi që është në lidhje dashurie me të dhe mendon të vazhdoj, dhe se i kanë rregulluar raportet në mes vete mirëpo para këtij rasti kanë pasur dhe raste të tjera dhe shton se ia ka falur të gjitha.

### **Vlerësimi i pranimit të fajësisë**

Gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë shqyrtoi me kujdes kushtet e parapara nga neni 248 par. 1 të KPRK-së dhe me këtë rast vlerësoi se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht, pranimi i fajit mbështet në faktet dhe prova materiale të rastit konkret si dhe materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit, dhe në provat tjera të cilat gjinden në shkresën e lëndës siç janë: raporti i oficerit i datës 25.09.2020, deklarata e dëmtuarës të dhënë në polici me datë 14.10.2020, ekspertiza mjeko-ligjore e datës 18.11.2020, si dhe informacionet mbi të kaluarën kriminale të të pandehurit.

Me qenë se i akuzuari e ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, gjyqtari në bazë të nenit 248 paragrafit 4 të KPRK-së, ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Gjykata po ashtu vërtetoi se prokurori ka disponuar me prova të mjaftueshme për veprën penale të të akuzuarit dhe ka dhënë mendimin për pranimin e fajësisë nga ana e tij.

Gjykata vërtetoi përtej çdo dyshimi se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par. 1 nënpar. 1.4 të KPRK-ës, meqë me datë, vend dhe kohë siç është përshkruar hollësisht në dispozitivin e këtij aktgjykimi, i pandehuri pas një fjalosjeje me të dëmtuarën duke vepruar me dashje e sulmon fizikisht duke e goditur disa herë me grushta duarthatë në fytyrë ku nga goditja e dëmtuar ka pësuar lëndime të lehta trupore, me të cilin veprim të dëmtuarës i ka shkaktuar lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin, të përshkruara në ekspretizën e ekpretit mjeko-ligjorë të datës 18 Nëntor 2020.

Nga interpretimi dispozitës të nenin 185 arrihet në përfundimin se: ligjvënësi ka parashikuar një mbrojtje të posaçme juridike në drejtim të mbrojtjes së jetës dhe integritetit fizik, të personit, cenimi i të cilit pas sjell përgjegjësi penale. Këto veprime, për t'u cilësuar si vepër penale nga ligji, duhet që të kenë prekur shëndetin e personit, konkretisht funksionimin normal të trupit të dëmtuarit, duke i sjellë dëmtime të përkohshme të shëndetit. Pos kësaj kjo vepër penale merr në mbrojtje jetën dhe trupin e njeriut. Në rastin konkret veprimet e dhunës fizike të ndërmarra nga i akuzuari janë përdorimi i forces me anë të grushtave me të cilën e ka goditur të dëmtuarën në fytyrë duke cenuar integritetin fizik, psikosocial e ekonomik të dëmtuarës andaj me këto veprime i ka shkaktuar lëndime të lehta trupore të përshkruara në ekspertizën mjeko - ligjore.

### **Caktimi i dënimit për të akuzuarin**

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të akuzuarin, Gjykata vlerësoi rrethanat në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-ës, si rrethanë veçanërisht lehtësuese vlerësoi pranimin e fajësisë për veprën penale të kryer, e cila është bërë në seancën e shqyrtimit fillestar, kurse në rastin konkret si rrethanë rënduese gjeti faktin se i pandehuri është recidivist dhe i dyshuar për vepra tjera penale ku përveç që vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale të të pandehurit si dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale, ndërsa me rastin e vlerësimi të rrethanave rënduese gjykata vlerësoi intensitetin e rrezikimit apo i dëmtimit të së mirës së mbrojtur pasiqë bëhet fjalë për vepër penale kundër jetës dhe trupit, ku me veprimet e tij i akuzuari i ka shkaktuar lëndime të lehta të dëmtuarit siç janë përshkruar në aktakuzë.

Mbi bazën e këtyre rrethanave, gjykata është e bindur se dënimi i shqiptuar është në harmoni me peshën e veprës penale dhe përgjegjësinë penale të të akuzuarit, duke marrë parasysh edhe

faktin se i njëjti ka bërë pranimin e fajësisë, duke vlerësuar se edhe me sanksion penal alternativ do të arrihet qëllimi i dënimit me kusht i paraparë me nenin 47 i KPRK-së, i cili përcakton se *”qëllimi i dënimit me kusht është që të mos zbatohet dënimi për vepra të lehta penale, kur vlerësohet se tërheqja e vërejtjes me kërcënimin e dënimit është e nevojshme të ndalojë që kryerësi të mos kryejë veprë penale”*, kështu që me dënimin e shqiptuar si në dispozitiv dhe pa ekzekutimin tij do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimit i paraparë në nenin 38 të KPRK-së, përkatësisht dënimi i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm, në përshtatje me rrethanat e kryerjes, rrezikshmërinë veprës penale dhe kryesit, që do të shërbej në parandalimin të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi që ti përmbaj personat e tjerë nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale).

### **Kërkesa pasurore juridike si dhe shpenzimet procedurale**

Vendimi lidhur me kërkesën pasurore-juridike është marr në kuptim të nenit 463 par. 1 dhe 2 të KPP-së, pasi që nga të dhënat e mbledhura gjatë zhvillimit të procedurës nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të pjesërisht.

Vendimi mbi shpenzimet procedurës gjyqësore është marr në kuptim të dispozitës së nenit 453 par. 1 të KPPRK-së, ndërsa për kompensimin e viktimave të krimit është marrë në bazë të nenit 39 par. 3 pika 3.1 të ligjit Nr. 05/L-036, për kompensimin e viktimave të krimit.

Në bazë të theksuarës më lartë u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

### **GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**

**Departamenti Përgjithshëm Penal,**

**P.nr.1023/20 i datës 02 Shtator 2022**

**Zyrtare Ligjore,**

**Gjyqtarja,**

Arta Podvorica

Mimoza SHABANI

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, nga dita e parë e ardhshme pas pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj, për Gjykatën e Apelit të Kosovës.